UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJ.A

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË** | **MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY** | **MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU**

Zyra e Sekretarit të Përhershëm | Office of Pemanent Secretary | Kancelarija Stalnog Sekretara

UDHËZIM ADMINISTRATIV

LËNDA: Aktivitetet politike në shkolla
NUMËR: MASHT[I] 14/2002
DATË: 16 shtator 2002

Në përputhje me Rregulloren nr. 2000/19 të dt. 4 tetor 2001 të Degës Ekzekutive të Kalimtare të Vetqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit ,Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ :

Paragrafi 1
Përcaktime

1.1 Për pikësynime të këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohen përcaktimet e mëposhtme :

Aktiviteti politik: përfshin mbajtjen e çfardo mbledhje qoft, fushtave, takimeve, grupeve shqyrtuese, rekrutimi I anëtarëve të rinjë, demonstrime apo çfarëdo aktiviteti tjetër per qëllime politike partiake.

Aktiviteti I votimit: përfshin ngritjen dhe administrimin ekabinave te votimit , listen zgjedhësve , vend trajnimet apo çfarëdo tjetër zyrtarisht qe është I nevojshëm per mbajtjen e zgjedhjeve kombëtare apo komunale.

Ndertesat e shkollave: janë te gjitha ndertesat, sallat, depot apo strukturat tjera qe ndodhen ne oborrin e shkollës.

Shkollat apo institucionet e lidhura me arsimin : këtu perfshihen te gjitha shkollat fillore, te mesme, universitetet, kolegjet, akademitë, konviktet, qendrat e studentëve

dhe te gjitha institucionet tjera arsimore ne Kosovë net ë cilat MASHT-I ushtron autoritetin e vet.

Paragrafi
Sherbimet e ndaluara

2,1 Rreptesisht është i ndaluar shfrytzimi i ndertesave shkollore apo i institucioneve te aferta me to per çdo aktivitet politik te pershkruar me lartë.

2.2 Shkollat dhe ndertesat shkollore mund te shfrytzohen per aktivitete votimi konform Udhëzimit te veqanta Administrative qe do t'I lëshoj MASHT-i sipas nevojes .

Paragrafi 3
Veprimet te ndaluara

3.1 Per secilin arsimtar , drejtor shkolle ,professor apo pjesëtar tjetër te personelit te MASHT-it është e kundërligjshme te udhëzoj nxënësit apo studentet për pjesëmarrje ne çfarëdo aktivitet politik qoftë.

3.2 Për secilin arsimtar ,drejtor shkolle, profesor apo pjesëtar tjetër të personelit te MASHT-it është e kundërligjshme te ndërpres mësimin për qëllime te angazhimit ne çfarëdo aktiviteti politik qoftë.

3.3 Për secilin arsimtar,drejtor shkolle, profesor apo pjestar tjetër te përsonelit të MASHT-it është e kundërligjshme të largohet apo të mos shkoje ne shkollë ose institucione te ngjashme për qëllime te pjesëmarrjes ne ndonjë ngjarje apo tubim politik apo për qëllime angazhimi ne çfarëdo aktiviteti politik qoftë siç u përshkrua me lartë ne paragrafin 1.

Paragrafi 4.
Disiplina

4.1 Secili nxënës apo student, arsimor, drejtor, profesor apo pjestare tjerë te personelit të MASHT-it, qe then rregullat e përshkruara në paragrfin paraprak do tu nënshtrohet masve disiplinore.

Paragrafi 5
Udhëzimet e shfuqizuara

5.1 Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ di të shfuqizohen dy Udhëzimet e mëhershme Administrative të lidhura me këtë çështje. Këto udhëzime janë:

a) DES 11/2000 Aktivitetet politike ne sistemin shkollor; dhe
b) DES [I] 26/2001 Aktivitetet politike.

Paragrafi 6
Hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ

6.1 Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me 16 shtator 2002

______________________________
Isuf Zeneli,
Sekretar i Përhershëm
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë